



Infrakos

RAPORTI (JANAR-MARS) 2023



Fushë Kosovë

Prill 2023

Përmbajtja

| | | |
|-----|---|----|
| 1. | Aktivitetet kryesore të INFRAKOS-it..... | 4 |
| 1.1 | Raportimi..... | 4 |
| 1.2 | Linja e 10 (dhjetë) hekurudhore | 5 |
| 1.3 | Mirëmbajtja e infrastrukturës | 5 |
| 1.4 | Struktura organizative e INFRAKOS-it..... | 6 |
| 2 | Departamenti i Infrastrukturës | 8 |
| 2.1 | Sektori i komunikacionit | 8 |
| 2.2 | Sektori i mirëmbajtjes së linjave hekurudhore | 11 |
| 2.3 | Sektori i veprimtarisë elektroteknike..... | 15 |
| 2.4 | Sektori për Planifikim Zhvillim Standardizim dhe Siguri | 17 |
| 3 | Departamenti i administratës..... | 20 |
| 3.1 | Sektori i Personelit | 20 |
| 4 | Sektori për marrëdhënie me publikun dhe Media Shkollim Mbrojtje dhe Siguri në Punë..... | 24 |
| 4.1 | Marrëdhëniet me publikun dhe media | 24 |
| 4.2 | Shkollimi siguria dhe mbrojtja në punë..... | 25 |
| 5 | Sektori i patundshmërisë..... | 27 |
| 6 | Sektori i prokurimit | 28 |
| 6.1 | Projektet kapitale nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës..... | 28 |
| 6.2 | Projektet e furnizimit nga Buxheti i INFRAKOS-it..... | 28 |
| 7 | Kontrollori i brendshëm | 29 |
| 8 | Performanca financiare e INFRAKOS-it..... | 32 |
| 8.1 | Të hyrat..... | 33 |
| 8.2 | Shpenzimet | 34 |
| 9 | Procedurat gjyqësore të INFRAKOS-it..... | 36 |
| 9.1 | Procedurat gjyqësore të INFRAKOS-it për tremujorin vijues..... | 36 |
| 9.2 | Përfundimet/sugjerimet dhe rekomandimet..... | 37 |
| 10 | Sugjerimet për ngritjen e performancës | 39 |

Lista e tabelave

| | | |
|-----------|--|----|
| Tabela 1. | Numri i trenave të udhëtarëve gjatë TM1 2023..... | 9 |
| Tabela 2. | Numri i trenave të mallrave gjatë TM1 2023 | 9 |
| Tabela 3. | Rastet e jashtëzakonshme TM1 2023 | 9 |
| Tabela 4. | Të hyrat e TRAINKOS-it në TM1 2023 | 10 |
| Tabela 5. | Të hyrat e RAILTRANS-it në TM1 2023 | 10 |
| Tabela 6. | Të hyrat në terminalin e mallrave në TM1 2023..... | 11 |
| Tabela 7. | Të dhënat kryesore për tremujorin e parë në sektorin e pronës..... | 27 |
| Tabela 8. | Të hyrat dhe shpenzimet në TM1 2023 | 32 |

Lista e shkurtesave

| | |
|----------|--|
| ARH | Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave |
| BE | Bashkimi Evropian |
| BEI | Banka Evropiane e Investimeve |
| BERZH | Banka Evropiane Për Rindërtim dhe Zhvillim |
| BNJ | Burimet Njerëzorë |
| EN | Energjetike |
| IPF | Infrastructure Project Facility-(Mbështetja e projekteve të Infrastrukturës) |
| IK | Infrakos |
| IT | Teknologjia Informative |
| KE | Komisioni Evropian |
| MLH | Mirëmbajtja Hekurudhore e Linjave |
| MMPHI | Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës |
| MPMSHSMP | Marrëdhënie me Publikun dhe Media Shkollim Siguri dhe Mbrojtje në Punë |
| MSA | Marrëveshja për Stabilizim dhe Asocim; |
| OSH | Projekti i shëndetit dhe sigurisë në punë |
| PIU | Njësia për Implementimin e Projektit |
| PZHK | Plani Zhvillimor Kombëtar |
| PZHSS | Planifikim Zhvillim Standardizim dhe Siguri |
| SMS | Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë |
| SS | Sinjalo-siguruese |
| TCPS | Sekretariati i Përhershëm i Komunitetit të Transportit |
| TK | Telekomunikuese |
| TM1 | Tremujori i parë |
| U.D. | Ushtrues Detyre |
| VE | Veprimtaria Elektroteknike |
| WBIF | Korniza Investive e Ballkanit Perëndimor |
| ZKM | Zyra e Kryeministrit |

1 Aktivitetet kryesore dhe struktura organizative e INFRAKOS-it



1. Aktivitetet kryesore të INFRAKOS-it

Vitin 2022, INFRAKOS-i e ka filluar duke u përballur me shumë sfida, por falë angazhimit maksimal të stafit, i ka tejkaluar dhe po i tejkalon me sukses. Megjithatë, gjendja financiare e vështirë, me dhe pa fajin e INFRAKOS-it, është një problem i vazhdueshëm që ka ndikuar edhe në tremujorin e parë të vitit. Si zakonisht, në tremujorin e parë të këtij fillim viti, prioriteti kryesor ka qenë mirëmbajtja dhe zhvillimi i infrastrukturës hekurudhore, për të mundësuar qarkullimin e trenave të udhëtarëve dhe mallrave pa probleme dhe në mënyrë të sigurt.

Punimet në rehabilitimin e Linjës 10 Hekurudhore do të duhej të përfundonin me datë 30 dhjetor 2022, në total punimet deri me tani kanë arritur të përfundohen 52% ndërsa koha për përfundimin e tërësishëm të projektit ka kaluar 100%, duke llogaritur riskun e lartë dhe nevojën imediate të këtij projekti kombëtar, INFRAKOS-i ka zhvilluar negociata me punë kryesin për ta gjetur një zgjidhje se si të dilet nga situata e krijuar në mënyrë që projekti të përfundoi, nga këto negociata palët Infracos dhe GCF (kontraktori) rënë dakord bashkërisht ta shtyjnë datën e përfundimit për arritjen e një marrëveshje për një shtojcë me Nr. 4 deri me 31.03.2023.

Punimet kanë vazhduar të realizohen edhe në fazën e dytë Fushë-Kosovë – Mitrovicë ku ka pasur zhvillime të theksuar të punimeve për rehabilitimin e këtij segmenti, punimet janë duke u realizuar sipas parashikimeve.

Departamentet dhe sektorët tjerë mbështetës janë angazhuar maksimalisht rreth financave, patundshmërisë, planifikim zhvillimit dhe ngritjeve të kapaciteteve njerëzore.

Theks i veçantë i është dhënë bashkëpunimit dhe bashkërendimit të veprimit Rëndësi e veçantë i është kushtuar bashkëpunimit dhe bashkërenditjes së veprimeve me institucionet përgjegjëse të shtetit lidhur me MSA-në, Programin e Reformave Ekonomike, Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit. Gjithashtu është punuar me përkushtim për të plotësuar detyrat e parapara me planin e veprimit të Komitetit Teknik mbi Hekurudhat të Komunitetit të Transportit për vendet e Ballkanit Perëndimor ku kemi marrë pjesë në dy takime që janë zhvilluar, një në Prishtinë dhe një në Tiranë, duke plotësuar dhe dorëzuar me kohë të gjitha informatat dhe të dhënat e ndryshme të kërkuara nga institucionet përkatëse.

1.1 Raportimi

Njëri ndër obligimet e shumta të INFRAKOS-it është i ndërlidhur me raportimin e rregullt për bordin e drejtorëve dhe institucionet përgjegjëse shtetërore lidhur me gjendjen e kompanisë dhe zhvillimet e ndodhura për periudha të caktuara kohore.

Gjatë tremujorit të parë të këtij viti INFRAKOS-i ka hartuar Raportin për muajt janar shkurt dhe mars të vitit 2023 këto raporte pas miratimit nga Bordi janë dërguar në Njësinë për Politikën dhe Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike duke përmbushur kështu edhe obligimet e raportimit për periudhën tremujore të këtij viti.

Sa i përket raportimit vlen të përmenden Departamenti i Infrastrukturës që është i ndarë në disa sektor të cilët ofrojnë shërbime të ndryshme, duke filluar nga sektori i komunikacionit për ofrimin e shërbimeve të organizimit të trafikut të trenave, ofrimin e shërbimeve tjera për operatorët e transportit hekurudhor, e deri te ofrimi i shërbimeve në terminalin e mallrave. Pastaj vjen ofrimi i shërbimeve të cilat i bënë sektori i patundshmërisë dhe kanë të bëjnë me dhënien me qira të banesave të INFRAKOS-it, lokaleve të ndryshme dhe pronës tjetër të kompanisë.

1.2 Linja e 10 (dhjetë) hekurudhore

Gjatë muajve janar, shkurt dhe mars edhe pse është tejkaluar koha për përfundimin e punimeve, kontraktori ka vazhduar me punime në fazën e parë të linjës së 10-të hekurudhore (Fushë Kosovë – Hani i Elezit), njëherit kemi zhvilluar negociatën me kontraktorin për mundësinë e vazhdimin të punimeve dhe shtyrjen e datës së përfundimit duke marrë parasysh ndërtimin e urave të reja. Në muajin shtator përkatësisht me datën 10.09.2022 kemi pasur një shembje në tunelin shtatë me pas edhe një shembje tjetër në tuneli gjashtë, nga kjo rezultoi mbyllja e linjës deri më tani. Realizimi dhe përsheptimi i punëve në realizimin e projektit mbeten detyrim i të gjitha palëve të angazhuara në këtë projekt që nga kontraktori, Mbikëqyrësi deri tek INFRAKOS-i.

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2023 ka pasur zhvillime të theksuar në punimet për rehabilitimin e fazës së dytë të linjës së 10-të hekurudhore (Fushë Kosovë – Mitrovicë), punimet janë duke u zhvilluar sipas planit dinamik dhe parashikimeve.

Ndër punët dhe detyrat e realizuara gjatë këtij tremujori vlen të përmenden:


- Ka vazhduar rehabilitimi i pjesës jugore (fazës së parë) të kësaj linje hekurudhore (Fushë Kosovë – Hani i Elezit), por përkundër kërkesave tona të vazhdueshme dhe takimeve të shumta me punë kryesin, vëllimi i punëve të kryera nuk ka qenë i kënaqshëm;
- Ka vazhduar rehabilitimi i fazës së dytë Fushë-Kosovë – Mitrovicë,
- Është duke u zhvilluar dizajni detaj dhe dosja e tenderit për projektin Rehabilitimi dhe modernizimi i fazës së tretë të linjës 10-të hekurudhore. Në lidhje me projektin e detajuar ka pasur disa zhvillime, ndryshimi nga IPF9 në IPF11,
- Për shkak të ndryshimeve nga IPF9 në IPF11 data e dorëzimit të projektit pritet të bëhet në TM4 2023, është një parashikim por kjo gjithnjë varet nga situata politike në këtë zonë.

1.3 Mirëmbajtja e infrastrukturës

Gjatë këtij tremujori të gjitha departamentet dhe sektorët e INFRAKOS-it kanë pasur një angazhim në mirëmbajtjen e infrastrukturës hekurudhore, sidomos në kohën me temperatura të ulëta edhe pse gjatë tremujorit të parë të vitit 2023 nuk kishte ngrica, mirëmbajtja e Infrastrukturës hekurudhore gjithnjë ka qenë në gjendje gatishmërie me një mbikëqyrje më të shtuar, ashtu që komunikacioni hekurudhor të zhvillohet pa probleme. Gjatë muajit janar në Republikën e Kosovës kishte vërshime, menaxhmenti i Infrakos-it i ka marrë të gjitha veprimet e nevojshme për ta mbrojtur trupin e hekurudhës, me punën, përkushtimin dhe angazhimin e ekipeve të mirëmbajtjes hekurudhat nuk kanë pasur ndonjë dëmtim. Në anën tjetër angazhimi i të gjitha sektorëve dhe punonjësve për realizimin e detyrave të parashtruara ka qenë shumë i madh. Përveç aktiviteteve të përmendura më lartë, janë zhvilluar edhe një numër i madh i aktiviteteve tjera të ndërlidhura me mirëmbajtjen, zhvillimin, funksionimin më të mirë dhe në tërësi për ngritjen e performancës së INFRAKOS-it. Vlen të ceket se gjatë këtij tremujori ka pasur mbyllje të linjës hekurudhore (Fushë-Kosovë – Hani i Elezit, Fushë-Kosovë – Mitrovicë) për shkak të ekzekutimit të punëve në rehabilitimin gjeneral të këtij segmenti hekurudhor. Përfundimisht, gjatë këtij tremujori përveç aktiviteteve të përmendura më lartë, janë zhvilluar edhe një numër i madh i aktiviteteve tjera të ndërlidhura me mirëmbajtjen, zhvillimin, funksionimin më të mirë dhe në tërësi për ngritjen e performancës së INFRAKOS-it.

1.4 Struktura organizative e INFRAKOS-it

Struktura organizative e INFRAKOS-it gjatë këtij tremujori të këtij vitit nuk ka pësuar ndryshime. Në figurën e më poshtme është paraqitur organogrami i funksionimit të Infracos-it.



Në tremujorin e parë të vitit 2023, INFRAKOS SH.A ka filluar me një staf prej 253 punëtorësh. Megjithatë, ka pasur disa ndryshime në numrin dhe statusin e punëtorëve. Një punëtor është pensionuar, ndërsa një tjetër ka ndërruar jetë. Një punëtor tjetër ka ndërprerë marrëdhënien e punës. Në këtë periudhë raportuese Bordi i përkohshëm në bazë të konkursit emëron Kryeshefi Ekzekutiv të ndërmarrjes. Si rezultat, në fund të muajit mars, INFRAKOS SH.A ka një staf prej 251 punëtorëve të rregullt. Përveç tyre, në këtë periudhë nga Qeveria e Kosovës emërohen katër anëtarë të Bordit me mandat, duke e bërë numrin e punëtorëve të arrin në 255.

2 Performanca afariste e INFRAKOS-it



2 Departamenti i Infrastrukturës

2.1 Sektori i komunikacionit

Gjatë muajve (janar, shkurt dhe mars) 2023 sektori i komunikacionit (Trafikut) ka qenë i përkushtuar në ofrimin e shërbimeve për operatorët e transportit hekurudhor, si TRAINKOS dhe RAILTRANS, në veçanti, departamenti ka punuar në përcjelljen dhe rregullimin e lëvizjes së sigurve të trenave, duke u kujdesur që të gjitha nevojat udhëtarëve të jenë të plotësuara dhe zbatimi me përpikëri i orarit të lëvizjes së trenave. Sa i përket lëvizjes së trenave të mallrave gjatë këtij tremujori nuk kemi realizuar asnjë lëvizje të trenave të mallrave.

Duke punuar me një angazhim 24 orë në ditë, sektori i Komunikacionit ka mundësuar që gjatë këtyre tre muajve të mos ketë asnjë vonesë apo anulim të trenave për shkak të punës së tij. Secila kërkesë nga operatorët e transportit TRAINKOS dhe RAILTRANS, (në veçanti TRAINKOS) për futjen në komunikacion të trenave që ishin paraparë në orarin e lëvizjes së trenave ose kërkesa për trase të jashtëzakonshme janë realizuar menjëherë.

Ky angazhim i vazhdueshëm dhe i përkushtuar i sektori të komunikacionit ka mundësuar që qarkullimi i trenave të jetë i sigurve dhe efikas në këtë periudhë tremujore.

Angazhimet tjera të sektori të komunikacionit janë paraqitur si në vijim:

- Udhëheqja e të dhënave bazë për lëvizjen e trenave (numrin e trenave të udhëtarëve, mallrave, rastet e jashtëzakonshme, të hyrat nga qasja në binarë, etj.);
- Shkollimi i rregullt sipas rregulloreve përkatëse të stafit ekzekutiv;
- Kontrollimi teknik i ndërrueseve së bashku me departamentet tjera;
- Kontrollimet teknike të stacioneve hekurudhore;
- Përcjellja e katër vendkalime të mbrojtura me barriera automatike në linjën Fushë Kosovë-Pejë. Licencimi i këtyre vendkalimeve pritet nga ARH-ja.

Vlen të përmendet se gjatë muajve janar, shkurt dhe mars në linjën hekurudhore Fushë Kosovë-Hani i Elezit deri tek Kufiri me Maqedoninë Veriore nuk kanë qarkulluar trenat që nga muaji shtator i vitit 2022 ku kemi pasur mbyllje të tërësishme të linjës për shkak të ekzekutimit të projektit dhe shembjes së tuneleve 6 dhe 7.

Sfidë e këtij departamenti mbetet mungesa e stafit ekzekutiv për rregullimin e komunikacionit hekurudhor.

2.1.1 Numri i trenave

Prioriteti numër një i këtij departamenti gjatë këtij tremujori ka qenë organizimi i qarkullimit të trenave të udhëtarëve dhe atyre të mallrave nëpër linjat hekurudhore.

Në tabelat vijuese janë paraqitur të dhënat mbi numrin e trenave të udhëtarëve dhe atyre të mallrave të cilët kanë qarkulluar në tremujorin e parë të këtij viti, duke e bërë krahasimin e tyre me të njëjtën periudhë kohore të vitit 2022.

Tabela 1. Numri i trenave të udhëtarëve gjatë TM1 2023

| Krahasimi i trenave | Trenat e udhëtarëve | | | | |
|-----------------------|--------------------------------|-------------------|---------------|-------------------|------------------------------|
| | Numri i trenave të planifikuar | Trenat e rregullt | Trenat ad hok | Trenat e revokuar | Numri i trenave të realizuar |
| | 1 | 2 | 3 | 4=1-2 | 5=2+3 |
| TM1-2023 | 540 | 538 | 0 | 2 | 538 |
| TM1-2022 | 540 | 0 | 0 | 0 | 540 |
| Diferenca (2023-2022) | 0 | -2 | 0 | 0 | -2 |

Tabela 2. Numri i trenave të mallrave gjatë TM1 2023

| Krahasimi i trenave | Trenat e mallrave | | | | |
|-----------------------|--------------------------------|-------------------|---------------|-------------------|------------------------------|
| | Numri i trenave të planifikuar | Trenat e rregullt | Trenat ad hok | Trenat e revokuar | Numri i trenave të realizuar |
| | 1 | 2 | 3 | 4=1-2 | 5=2+3 |
| TM1-2023 | 516 | 0 | 0 | 516 | 0 |
| TM1-2022 | 603 | 4 | 5 | 599 | 9 |
| Diferenca (2023-2022) | -87 | -4 | --5 | -83 | -9 |

Sipas tabelës së mësipërme, shihet që numri i trenave të udhëtarëve të planifikuar në tremujorin e parë të këtij viti është i njëjtë me numrin e trenave të udhëtarëve të njëjtës periudhë të vitit të kaluar, megjithatë, krahasuar në këtë periudhë të këtij viti janë revokuar dy trena, ndërsa në vitin e kaluar në të njëjtën periudhë kanë qarkulluar të gjithë trenat e planifikuar.

Sa i përket numrit të trenave të mallrave në periudhën kohore TM1 të këtij viti, shihet një rënie drastike të numrit të trenave, pasi siç tregohet në tabelën e mësipërme numri i trenave të mallrave është zero, kjo ndodhi si pasojë e punimeve në linjën hekurudhore Hani i Elezit – Fushë Kosovë dhe ndërprerja e punës së Xeherores së Feronikelit,

2.1.2 Numri i aksidenteve

Shqetësimin më të madh dhe njëri ndër problemet më kryesore të sektorit të komunikacionit e paraqesin rastet e jashtëzakonshme, apo aksidentet të cilat ndodhin në linjat tona hekurudhore. Në tabelën e më poshtme janë paraqitur aksidentet të cilat kanë ndodhur në tremujorin e parë të këtij viti duke i krahasuar ato me të njëjtën periudhë të vitit paraprak.

Tabela 3. Rastet e jashtëzakonshme TM1 2023

| Rastet e jashtëzakonshme | Numri total i aksidenteve | Vlera e dëmeve materiale | Numri i personave të lënduar | Numri i personave të vdekur |
|--------------------------|---------------------------|--------------------------|------------------------------|-----------------------------|
| TM1-2023 | 2 | 0.00 € | 2 | 0 |
| TM1-2022 | 2 | 0.00€ | 2 | 0 |
| Diferenca (2023 - 2022) | 0 | 0.00 € | 0 | 0 |

Nga tabela shihet se kemi pasur gjithsejtë dy raste të jashtëzakonshme. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022 shihet se nuk kemi ndryshime në numrin e rasteve të aksidenteve. Në këto aksidente nuk kemi pasur ndonjë person të vdekur ndërsa kemi pasur dy persona të lënduar. Vlen të ceket se të gjitha rastet e jashtëzakonshme janë të trajtuara nga komisioni profesional për rastet e jashtëzakonshme i përbashkët nga INFRAKOS-it dhe TRAINKOS-it, si dhe Policia e Kosovës.

Është me rëndësi të theksohet se asnjëri prej rasteve të jashtëzakonshme të përmendura më lartë nuk ka ardhur si pasojë e INFRAKOS-it.

2.1.3 Shërbimi i qasjes në binarë

Shërbimi i qasjes në rrjet ka përcjell me sukses lëvizjen e vazhdueshme të të gjitha mjeteve lëvizëse në rrjetin hekurudhor të INFRAKOS-it duke kalkuluar edhe faturimin e pagesave të qasjes në binarë si dhe të gjitha shërbimeve tjera shtesë të ofruara nga INFRAKOS-i për operatorët e transportit TRAINKOS dhe RAILTRANS. Në tabelat në vijim është paraqitur krahasimi i të hyrave për tremujorin e parë të vitit 2023 me tremujorin e parë të vitit 2022 për operatorin TRAINKOS dhe atë RAILTRANS.

Tabela 4. Të hyrat e TRAINKOS-it në TM1 2023

| Periudha kohore | Të hyrat nga trenat e udhëtarëve | Të hyrat nga trenat e mallrave | Të hyrat nga trenat jo të rregullt – ad hok | Të hyrat nga shërbimet tjera | Të hyrat totale |
|-----------------------|----------------------------------|--------------------------------|---|------------------------------|-----------------|
| TM1-2023 | 38,493.50 | 0.00 | 0.00 | 3,387.28 | 41,880.78 |
| TM1-2022 | 38,521.80 | 0.00 | 0.00 | 4,085.35 | 42,637.61 |
| Diferenca (2023-2022) | -28.30 | -30.46 | 0.00 | -698.07 | -756.83 |

Tabela 5. Të hyrat e RAILTRANS-it në TM1 2023

| Periudha kohore | Të hyrat nga trenat e mallrave | Të hyrat nga trenat jo të rregullt – ad hok | Të hyrat nga shërbimet tjera | Të hyrat totale |
|-------------------------|--------------------------------|---|------------------------------|-----------------|
| TM1-2023 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| TM1-2022 | 0.00 | 0.00 | 175.40 | 175,40 |
| Diferenca (2023 – 2022) | 0.00 | 0.00 | -175,40 | -175,40 |

Pasqyrimi i të dhënave në tabelat e mësipërme tregon qartë se në tremujorin e parë të këtij viti ka rënie e të hyrave nga dy operatorët e Transportit TRAINKOS dhe RAILTRANS, operatori TRAINKOS ka realizuar për 756.83 € më pak, ndërsa operatori RAILTRANS gjatë kësaj periudhe ka qenë zero në krahasim me vitin e kaluar ka realizuar për 175.40€ më pak.

Kjo është shqetësuese për INFRAKOS-in, pasi të hyrat kryesore të kompanisë varen nga qasja në binarë e këtyre dy operatorëve për transportin e mallrave. Në këtë periudhë operatori TRAINKOS ka revokuar të gjithë trenat e rregullt të paraparë me orar të lëvizjes së trenave. Ndërsa operatori RAILTRANS nuk ka parapa trena të rregullt të mallrave për vitin 2023. Kjo rënie

e të hyrave nga qasja në rrjet nga operatorët transportues paraqet një problem shtesë financiar për kompaninë tonë.

2.1.4 Terminali i mallrave

Në këtë tremujor, ngjashëm me vitin e kaluar për fat të keq numri i kontejnerëve të transportuar në terminal ka qenë zero, gjë që ka ndikuar automatikisht në rënien e të hyrave të terminalit për shërbimet e ofruara.

Tabela 6. Të hyrat në terminalin e mallrave në TM1 2023

| Periudha kohore | Numri i kontejnerëve | Të hyrat nga vinqi | Të hyrat nga piruneri | Të hyrat nga fletëhyrjet | Totali i të hyrave |
|-----------------------|----------------------|--------------------|-----------------------|--------------------------|--------------------|
| TM1-2023 | 0 | 0.00 | 40.00 | 40.00 | 80.00 |
| TM1-2022 | 0 | 0.00 | 60.00 | 60.00 | 120.00 |
| Diferenca (2023-2022) | 0 | 0.00 | -20.00 | -20.00 | -40.00 |

2.2 Sektori i mirëmbajtjes së linjave hekurudhore

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2023, sektori MHL-së është marrë me aktivitetet e mirëmbajtjes së linjave hekurudhore dhe infrastrukturës tjetër përcjellëse në mënyrë që qarkullimi i trenave dhe mjeteve tjera lëvizëse të bëhet pa problem dhe me sigurinë maksimale. Sektori i MHL-së përkundër vështirësive financiare të kompanisë ka arritur që të ruaj një nivel të kënaqshëm në mirëmbajtjen e infrastrukturës ekzistuese hekurudhore, përfshirë këtu binarët hekurudhor me tërë infrastrukturën e tyre përcjellëse, urat, tunelet, lëshesat, kanalet ujë përcjellëse, platotë për ngarkim/shkarkimin e mallrave, vendkalimet në nivel, si dhe të gjitha objektet tjera për ofrimin e shërbimeve hekurudhore.

Gjatë muajit janar në disa zona të vendit kishte vërshime, sektori i mirëmbajtjes së linjave hekurudhore ka dal në vendet ku për shkak të vërshimeve mund të dëmtohej hekurudha, ekipet e mirëmbajtjes kanë marrë të gjitha veprimet e nevojshme për ta mbrojtur trupin e hekurudhës, me punën, përkushtimin dhe angazhimin e ekipeve të mirëmbajtjes hekurudhat nuk kanë pas ndonjë dëmtim.

Në vijim janë prezantuar detyrat kryesore të realizuara në këtë tremujor:

- Ndërrimi i traversave në ndërruese;
- Ndërtimi i pronave;
- Rregullimi i niveletës nëpër ndërruese;
- Ngritje e ramjeve të shkurta;
- Planifikimi i koltrinės;
- Pastrimi i profilit;
- Pastrimi i kanaleve ujë përcjellës;
- Pastrimi i lëshesave;
- Rrënimi i vendkalimeve ilegale;
- Rregullimi i gjeometrisë së binarëve me makinat Pllaser 08 16 SH;
- Transporti i punëtorëve për realizimin e punëve në linjat hekurudhore;
- Mirëmbajtja e rregullt e makinave Plasser;
- Pastrimi dhe rregullimi i konstruksionit të vendkalimeve;

- Ngarkimi dhe shkarkimi i traversave;
- Kontrollimi i hekurudhës dhe objekteve;
- Sigurimi i vendkalimit km 280+110;
- Sigurimi fizik i objekteve (Drejtorisë, Elektros ,Terminalit dhe te makinat Plasser);
- Vëzhgimi i rregullt i binarit;
- Kontrollimi teknik i ndërrueseve;
- Mirëmbajtja e objekteve dhe pajisjeve sanitare;
- Eliminimi i defekteve në rrjetin e nxehjes qendrore;
- Përgatitja e specifikacionit për projektet të investuara nga BKK.

2.2.1 Rregullimi i gjeometrisë së binarit

Gjatë TM1 të këtij viti është bërë kontrollimi i rregullt i hekurudhës dhe objekteve përcjellëse sipas planifikimit mujor dhe duke u bazuar në rregulloret ekzistuese. Kontrollimet janë kryer si kontrollime vizuale të hekurudhës dhe objekteve nëpër linjat hekurudhore duke ecur dhe duke evituar mangësitë e identifikuar në kohë sa më të shkurtë. Një punë e madhe është bërë edhe në përcjelljen e gjendjes së binarëve, kështu që pas evidentimit të mangësive eventuale është bërë intervenimi i menjëhershëm me makineritë dhe personelin e mirëmbajtjes për evitimin e të gjitha prishjeve duke e bërë rregullimin e binarëve sipas standardeve të kërkuara.

2.2.2 Rregullimi i gjeometrisë së binarit sipas kahut dhe niveletës me fuqi punëtore dhe makina plaser

Njëra nga punët kryesore gjatë mirëmbajtjes së linjave hekurudhore ka të bëjë me rregullimin e deformimeve të niveletës, kahut dhe planifikimi i koltrinës-balastit në linjat hekurudhore. Në mënyrë që të kemi linja të sigurta për transportin e udhëtarëve dhe mallrave, gjatë këtij tremujori është bërë mirëmbajtja e rregullt e të gjitha linjave hekurudhore në funksion, mirëmbajtja është bërë me anë të makinave Plasser.

Në fotografitë në vazhdim janë paraqitur gjendja e deformimeve të binarëve dhe gjendja pas intervenimit dhe rehabilitimit të binarit në linjë të hapur.



Gjendja para intervenimit



Gjendja pas intervenimit

2.2.1 Mirëmbajtja dhe kontrollimi i ndërrueseve



Departamenti për mirëmbajtjen e linjave hekurudhore ka bërë kontrollimin vizual të ndërrueseve tri herë në muaj dhe një herë me matje. Së bashku me Departamentin e veprimtarisë elektroteknike dhe Departamentin e Komunikacionit ka bërë kontrollimin teknik të ndërrueseve një herë në muaj. Te linjat hekurudhore të cilat nuk kanë zhvillim të rregullt të komunikacionit, kontrollimet janë bërë sipas Rregullores 314.


Gjatë kësaj periudhe është bërë edhe mirëmbajtja e ndërrueseve dhe pastrimi i tyre nga reshjet e bores. Në këtë pozicion të punëve bëhet rregullimi i deformimeve të niveletës, kahut, pjesëve të dëmtuara dhe planifikimi i koltrinës-balastit nëpër ndërruese të stacioneve hekurudhore. Kjo punë është kryer me mjaft sukses duke përdorur makinën Plasser e cila e mundëson një

gjë të tillë. Kjo mirëmbajtje ka garantuar një qarkullim të sigurt të trenave të udhëtarëve dhe mallrave.

2.2.2 Zëvendësimi i traversave të vjetërsuara

Njëra ndër punët më të rëndësishme në mirëmbajtjen e infrastrukturës hekurudhore ndërlidhet me mirëmbajtjen e rregullt dhe evitimin e mangësive nëpër binarët hekurudhor, përfshirë këtu zëvendësimin e traversave të vjetërsuara të cilat e cenojnë sigurinë e komunikacionit hekurudhor. Gjatë këtij tremujori është bërë zëvendësimi i rregullt i traversave të vjetërsuara në linjë të hapur dhe binarë të stacionit hekurudhor ashtu që të garantohet siguria maksimale e qarkullimit të trenave.

Në fotografitë e më poshtme paraqitet ndërimi i traversave në stacione dhe në linjë të hapur.



Ndërimi i traversave në linjë të hapur dhe në binaret e stacionit

2.2.3 Rregullimi i zonave të vendkalimeve në nivel



Duke parë se shumica e aksidenteve kanë ndodhur dhe ndodhin në vendkalimet në nivel të njëjtë hekurudhë – rrugë, atëherë njëra nga detyrat me prioritet të lartë gjatë këtij tremujori ka qenë e ndërlidhur me rregullimin e zonës së vendkalimeve në nivel të njëjtë. Kjo punë është kryer me sukses dhe të gjitha vendkalimet e rregulluara tani kanë një nivel të kënaqshëm gjë që mundëson një lëvizje më të lehtë të automjeteve rrugore. Në fotografitë janë paraqitur punëtorët duke rregulluar dhe niveluar vendkalimin në nivel rrugë - hekurudhë.

2.2.4 Pastrimi i profilit të lirë dhe kanaleve ujë përcjellëse

Në tremujorin e parë 2023 është bërë pastrimi i vazhdueshëm i profilit të lirë në të gjitha linjat hekurudhore ku janë duke operuar trenat ashtu që linjat hekurudhore të garantojnë sigurinë maksimale të qarkullimit të trenave. Departamenti i MLH-së e ka një përvojë të gjatë dhe ekspertizë të mjaftueshme për realizimin e mirëmbajtjeve të tilla dhe kjo bëhet sipas standardeve dhe rregulloreve në fuqi.



Pastrimi i profilit dhe kanalit ujë përcjellës

2.2.5 Lyerja dhe përpunimi i bulonave

Mirëmbajtja e pjesëve përforcuese të binarëve është punë e një rëndësie të veçantë pasi që me këtë sigurohet që binari të ketë parametrat e kërkuar për të garantuar sigurinë e qarkullimit të trenave. Prandaj njëra ndër punët e realizuara gjatë këtij tremujori ndërlidhet edhe me lyerjen dhe përforcimin e bulonave mbajtës të shinave në traversat e binarëve, punë kjo e cila bëhet në mënyrë të vazhdueshme.

2.2.6 Planifikimi i koltrinės

Planifikimi i prizmës i koltrinės është bërë në linjë të hapur dhe nëpër ndërruese. Planifikimi është bërë me makinën SSP 103 dhe me fuqi punëtore. Në periudhën Janar-Mars – 2023 është punuar në të gjitha linjat hekurudhore.

2.3 Sektori i veprimtarisë elektroteknike

Sektori i veprimtarisë elektroteknike ka arritur me sukses realizimin e objektivave të parapara me Planin e Veprimit i cili është përgatitur në kuadër të Planit të Biznesit për vitin 2023. Objektiv i kryesor i këtij sektori ishte mirëmbajtja e pajisjeve SS, TK, EN dhe IT në mënyrë që ato të kryejnë me sukses misionin për të cilin janë dedikuar. Në kuadër të këtij objektiv sektori ka ndërmarrë veprime të vazhdueshme, evitim të shpejtë të pengesave duke intervenuar edhe jashtë orarit të punës në mënyrë që të mos ketë probleme gjatë qarkullimit të trenave.

Objektivat e sektorit të VE-së në këtë tremujor kanë qenë:

- Ngritja e sigurisë së komunikacionit hekurudhor;
- Mirëmbajtja e rregullt dhe funksionale e pajisjeve SS,TK, EN dhe IT;
- Përcjellja e Projektit për Rehabilitim të hekurudhës;
- Furnizim me pjesë rezervë për vendkalimin dhe kthimin në funksion i vendkalimit në Bardh;
- Shpenzimet buxhetore në Departament (Janar, shkurt dhe mars 2023);

Meqenëse pajisjet sinjalo siguruuese, telekomunikuese dhe ato të energjetikës janë të shtrira në tërë rrjetin hekurudhor, në vazhdimësi këto pajisje kenë probleme të ndryshme për shkak të ndikimeve të palëve të treta mbi këto pajisje.

Në këtë tremujor, të gjitha shërbimet e këtij sektori kanë arritur me sukses ti realizojnë detyrat e parapara, përfshirë pajisjet sinjalo siguruuese, telekomunikuese të energjetikës dhe ato të IT edhe pse në kushte të vështira, për shkak të pamjaftueshmërisë së pjesëve rezervë, pajisjet gjatë gjithë kohës kanë qenë në funksion të plotë.

Për shkak të punimeve ndërtimore në rehabilitim të linjës hekurudhore janë shkyçur sistemet SS në stacionet nga Fushë-Kosova – Mitrovicë. Shkyçja e pajisjeve SS ka ardhur me anë të Urdhëresës Nr.100 të datës 16.02.2023.

Tani jashtë funksioni janë pajisjet SS dhe stacionet Lipjan, Bablak, Ferizaj, Gurëz, Kaçanik dhe Hani i Elezit, ndërsa me fillimin e fazës së dytë edhe stacionet nga Fushë-Kosova – Mitrovicë janë të pa siguruara me sistem sinjalizimi, me urdhëresë janë shkyçur edhe pajisjet e vendkalimeve të mbrojtura në zonën e stacionit që janë të ndërlidhura me rrugë udhëtime. Për shkak të punimeve këto sisteme të stere vjetruara nuk mund të kthehen më në përdorim, sigurimi i këtyre stacioneve, deri në instalimin e sistemeve të reja, do të bëhet në mënyrë manuale.

Tani e tutje rregullimi lëvizjes së trenave në stacion bëhet ashtu siç e parash rregullorja e komunikacionit në rastet kur sinjalet nuk punojnë.

Në këtë periudhë të raportimit, sektori ka realizuar një sërë aktivitete dhe detyrash. Një sasi e materialit të blerë gjatë vitit të kaluar është futur në përdorim edhe gjatë muajit janar 2023. Nga PIU-ja është kërkuar të rritet presioni të kontraktori për riparimin e kabllave të dëmtuara gjatë renovimit të linjës hekurudhore në fazën e parë, deri më tani nuk është marrë ndonjë veprim konkret. Gjatë gjithë kohës janë inspektuar pajisjet SS, TK, EN dhe TI nëpër stacione, ndërsa në Bardh është kthyer në funksion vendkalimi. Shërbimi i EN-së është angazhuar në ndërrimin e ndriçimit në objektet e Infrakos-it në mënyrë që të zvogëlohen shpenzimet e energjisë, ndriçimi

nga dritat e vjetra ka kaluar në ato të reja të tipit LED të cilat zvogëlojnë shpenzimet energjetike deri në 75%. Ndërsa shërbimi i TI gjatë kësaj periudhe kohore pos tjerash ka vër në funksion edhe 57 kompjuterë të ri të cilët i shërbejnë stafit të Infracos-it.

Intervenimeve për eliminimin e pengesave, riparimet e ndryshme dhe disa nga detyrat kryesore të realizuara në këtë periudhë kohore janë renditur në vijim:

1. Pajisjet SS

- Inspektimi i pajisjeve SS ne stacioni Obiliq dhe Prelluzhë,
- Shkyçja e sistemit të sinjalizimit në stacionet Obiliq, Prelluzhë, Vushtrri dhe Mitrovicë,
- Intervenime të ndryshme në vendkalimet hekurudhë-rrugë të mbrojtura me gjysmëmbrojtës në Drenas, Bardh, Qikatovë, Klinë, Grabovc, Pejë, me intervenimet e bëra vendkalimet janë kthyer në gjendje të rregullt .
- Janë demoluar RTU-të dhe pajisjet e numëruesve të boshteve në Obiliq, Prelluzhë, Vushtrri, Mitrovicë, Lipjan, Bablak, Ferizaj, Gurëy, etj.

2. Pajisjet TK

- Furnizimi me bateri, testimi dhe funksionalizimi i repetitorit në Ivajë,
- Monitorimi dhe evitimi i pengesave të ndryshme në kamera telefoni dhe radiolidhje,
- Intervenime (në disa raste së bashku me telekomin) në riparimin e këputjeve të kablllove optike, etj.

3. Pajisjet EN

- Ndërrim i sistemit të ndriçimit në objektet e Infracos-it nga sistemi i vjetër në sistemin e ri LED,
- Mirëmbajtja e pajisjeve elektro-energjetike në të gjitha stacionet,
- Kontrollimi i gjendjes së shpenzimeve në stacionin qendrorë dhe stacioneve përgjatë linjave hekurudhore, etj.

4. Pajisjet IT

- Instalimi dhe vënia në funksion e 57 kompjuterëve të rinj, si dhe intervenime tjera në sistemet e kompjuterëve,
- Instalimi i printerëve, fotokopjeve dhe kyçja e shfrytëzuesëve në fotokopje,
- Intervenime në servera
- Publikime në web-faqen e Infracos-it, etj.



Repetitori në Ivajë dhe Drenas



Ndriçim i objekteve të Infrakos-it me LED

Ndër sfidat kryesore me të cilat sektori i veprimtarisë elektroteknike vazhdimisht përballet janë vjedhjet e vazhdueshme të kablove apo pajisjeve tjera sinjalo siguruese si dhe mungesa e pjesëve rezervë.

2.4 Sektori për Planifikim Zhvillim Standardizim dhe Siguri

Sektori për PZHSS, gjatë periudhës TM1 2023 ka vazhduar punën me qëllim të sigurimit të ngritjes së performancës së sektorit në funksion të shërbimit të interesave të kompanisë. Ky ka qenë një synim i vazhdueshëm për të plotësuar kriteret dhe nevojat për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës hekurudhore.

Ky raport reflekton mbi aktivitetin e stafit të sektorit për PZHSS përfshirë zhvillimet më të rëndësishme, reflekton punën e kryer në periudhën tremujore. Në këtë periudhë është vazhduar me zbatimin e planin vjetor të punës së sektorit dhe është bërë përcjellja e punëve të cilat janë të ndërlidhura me këtë sektor, duke i siguruar sektorit një performancë të lartë në shërbimin e interesave të kompanisë.

Objektivat e sektorit gjatë kësaj periudhe kanë qenë si në vijim:

- Ngritja e kapaciteteve njerëzore drejt rritjes së sigurisë, kualitetit dhe efektivitetit të infrastrukturës hekurudhore;
- Ngritja e bashkëpunimit brenda kompanisë, me institucione vendore dhe ndërkombëtare me qëllim të ngritjes së sigurisë dhe modernizimit të linjave hekurudhore;
- Hulumtimi i zhvillimeve, të arritave në teknologjinë e sistemeve hekurudhore dhe propozimet e mundshme për zbatimin e tyre;
- Përpilimi i analizave financiare duke u mbështetur në kornizat buxhetore dhe projekte.

Aktivitetet kryesore dhe rezultatet e arritura janë paraqitur në vijim:

- Ofrimi e mbështetjes profesionale në realizimin e kërkesave të ndryshme në nivel të kompanisë dhe detyrave të dala nga mbledhjet e menaxhmenti;
- Hartimi i koncept dokumentit për rregullimin e hapësirave para stacionit qendrorë në Fushë-Kosovë, si dhe projektimi i sinjalizimit horizontal dhe vertikal në këtë zonë;
- Ofrimi i mbështetjes profesionale në plotësimin e formularëve të Enti te Statistikave të Kosovës;
- Hartimi i koncepte dokumentit mbi gjendjen aktuale edhe evidentimin e eksponateve në “Muzeun e Hekurudhave të Kosovës” edhe mundësin e regjistrimit si muze industrial i Kosovës;
- Ofrimi i mbështetjes profesionale në plotësimin e kërkesave nga ZKM-ja për kontributit/inputit të parë të institucioneve të Republikës së Kosovës për Raportin e KE-së për Kosovën – 2022;
- Angazhimi në hartimin e informatave lidhure PZHK-në, sfidat në zbatimin e projekteve të përcaktuar në PZHK;
- Hartimi dhe analiza e konsumit të energjisë për ngrohje në stacionet hekurudhore në Prishtinë dhe Fushë Kosovë
- Mbështetja profesionale për pjesën sa i takon Infrakos-it për zbatim të projektit “Vlerësimi i tregut hekurudhor në Ballkanin Perëndimor për sa i përket kapaciteteve, politikave, nivelit ekonomik dhe teknik të zhvillimit të segmenteve të transportit të mallrave dhe udhëtarëve”, nga Sekretariati i Përhershëm i Komunitetit të Transportit (TCPS).
- Mbështetja profesionale për pjesën sa i takon Infrakos-it për përpilimin e “Koncept Dokumentit” për plotësim ndryshimin e Ligjit për hekurudha dhe Ligjit të ri për Siguri dhe Interoperabilitetin hekurudhor.

2.4.1 Shërbimi i Standardeve

Bazuar në Ligjin për Hekurudhat e Kosovës 2001/04-L-063 i cili kërkon që raporti vjetor i sigurisë së vitit të kaluar të përgatitet dhe të dorëzohet deri me 30 Qershor të vitit aktual, Shërbimi i Standardeve dhe Sigurisë është marrë me grumbullimin, përpunimin dhe hartimin e Raportit Vjetor të Sigurisë i cili si procese edhe më tutje vazhdon dhe i cili do të jetë i gatshëm për ta dërguar në ARH në afatet e parapara e që fundi i dorëzimit të raportit është 31 Maj 2023. Ky raport do të jetë gjithëpërfshirës me analiza, dhe pamje grafike, me fokus në paraqitjen reale të nivelit të sigurisë në komunikacionin hekurudhor dhe në ngritjen e kulturës së sigurisë në komunikacionin hekurudhor.

Marrë parasysh se autorizimi i sigurisë skadonte me datë 29 Mars 2023, kjo u bë detyrë prioritare dhe përveç plotësimit të formularit, u punua edhe në përditësimin e Doracakut të SMS –të, si pasojë e ndryshimeve të cilat kanë ndodhur në Strukturën Organizative të Infrakos-it. Përditësimi i dokumentacionit u bë edhe në të gjitha dokumentet tjera përcjellëse përfshirë edhe dokumentet si Deklaratat e Përputhshmërisë të cilat, patjetër se duhej të përputheshin me ndryshimet organizative dhe përgjegjësi të cilat u takojnë Departamenteve dhe Sektorëve përkatës në ruajtjen dhe ngritjen e Sigurisë në Komunikacionin Hekurudhor. Të gjitha këto janë përgatitur dhe janë nënshkruar dhe më pas është siguruar buxheti dhe janë bërë pagesat. Së bashku me pagesat u proceduan tek ARH – Departamenti i Sigurisë për rishikim dhe për aprovim.

Vazhdimi i Autorizimit të sigurisë Pjesa A dhe B

Si rezultat i këtij angazhimi në kohë u arrite që të vazhdohet Autorizimi i Sigurisë pjesa A dhe B, u vazhduan për një periudhë pesë vjeçare dhe tani INFRAKOS posedon Autorizimin deri me 28 Mars 2028, duke përmbushur obligimin kryesorë për ofrimin e Infrastrukturës Hekurudhore në përdorim për klientët tanë.

Detyrat tjera

Gjatë kësaj periudhe shërbimi i standardeve është marrë edhe me takime të ndryshme, në Mbledhjen e Nënkomisionit për Energji, Mjedis, Transport dhe Zhvillim Rajonal me shoqërinë civile, me qëllim përgatitjen dhe hartimin e raportit, i cili më pas ishte bazë për një takim virtual me përfaqësues të Komisionit Evropian, të cilët menaxhojnë Nënkomitetin për Energjinë, Mjedisin, Transportin dhe Zhvillimin Rajonal.

Aktivitetet në vazhdim

Puna në Kompletimin e Raportit vjetorë të Sigurisë si dhe përgatitja e Draft Rregullores për kërkesat teknike për sigurinë e trafikut hekurudhor që duhet të plotësojnë linjat hekurudhore, edhe pse kjo është detyrë e MMPHI, Shërbimi për Standarde po përgatit dhe përkthen draftet nga legjislacioni Kroat meqë konsiderohet se janë përfshirë edhe standardet dhe kërkesat e BE-së për Infrastrukturën dhe Komunikacionin Hekurudhor.

Zyra PZHSS përveç punëve dhe detyrave të përkthura më lartë, ka vazhduar të kryej edhe punët që janë paraparë në planin e veprimit të kësaj zyre për tremujorin e parë të këtij viti si dhe është angazhuar në punë tjera gjithnjë për nevojat e INFRAKOS-it.

Përkundër sfidave të caktuara, ne mund të konstatojmë se performanca e Sektori për Planifikim Zhvillim, Standardizim dhe Siguri gjatë tremujorit të parë të këtij viti ka qenë në nivelin e duhur dhe se ky sektor do të vazhdon t'i realizoj me sukses detyrat e parapara edhe në tremujorin vijues.

3 Departamenti i administratës

Departamenti Administratës së Përgjithshme ka zhvilluar një aktivitet të konsideruar edhe gjatë këtij tremujori të vitit 2023 në përpjekje për të përmbushur objektivat e këtij departamenti dhe kompanisë në tërësi. Në secilin sektor dhe shërbim është punuar në vazhdimësi për arritjen e objektivave të planifikuara dhe këtë ia ka arritur me mjaft sukses.

3.1 Sektori i Personelit

Ka pasur angazhim të vazhdueshëm në administrimin e personelit dhe detyrave tjera, me synim arritjen e objektivave. Detyrat e realizuara të këtij sektori në mënyrë të detajuar janë paraqitur në tekstin vijues.

Ky sektor në mënyrë aktive ka punuar dhe punon në menaxhimin e burimeve njerëzore duke realizuar me sukses të gjitha detyrat e parapara me planin e biznesit, respektivisht me planin e veprimit të kompanisë.

Objektivat sipas planit të biznesit për të cilat ka pasur angazhim maksimal për realizimin e tyre janë prezantuar në vijim:

- Menaxhimi i rregullt i burimeve njerëzore (punësimi, largimi, pensionimi);
- Pagat dhe kompensimet tjera të punëtorëve;
- Disiplina në punë;
- Ofrimi i shërbimeve dhe informatave të nevojshme për punëtorët dhe palët e interesuara;
- Planifikimi dhe mbikëqyrja administrative e shfrytëzimit të pushimeve vjetore.

Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës Infrakos SH.A. në fillim të vitit 2023 ka startuar me 255 punëtorë të rregullt dhe katër anëtarë të bordit, ndërsa me anëtarët e bordit numri i të punësuarve arrin në 259 punëtor, mund të themi jemi në minimumin e mundshëm të punëtorëve e sidomos në sektorin e Infrastrukturës. Ndërsa përfundimin e periudhës TM1 e përfundojmë me 257 punëtorë duke i përfshirë edhe katër anëtarët e Bordit. Një punëtor ka dalë në pension ndërsa një ka vdekur.

Struktura e të punësuarve më 01/01/2023 varësisht nga kategoritë është si vijon:

- Punonjës me marrëdhënie të rregullt të punës janë 253 prej të cilëve 252 ose 98.43% kanë kontrata pune në afat të pa caktuar.
- Meshkuj janë 235 të punësuar dhe përbëjnë 92% nga totali i të punësuarve
- Femra janë 18 të punësuar dhe përbëjnë 7% nga totali i të punësuarve
- Shqiptarë janë 246 të punësuar dhe përbëjnë 97% nga totali i të punësuarve
- Serb janë 6 të punësuar dhe përbëjnë 2% nga totali i të punësuarve
- Ashkalinjë dhe rom janë 1 i punësuar dhe përbëjnë 0,39% nga totali i të punësuarve
- Me shkollë fillore ose të kualifikuar nga Hekurudhat kemi gjithsejtë 34 punëtorë
- Me shkollë të mesme kemi gjithsejtë 147 punonjës
- Me shkollë të lartë kemi gjithsejtë 6 punëtorë dhe
- Me shkollim superior kemi gjithsejtë 66 punëtorë

3.1.1 Menaxhimi i rregullt i Burimeve Njerëzore (punësimi, largimi, transferimi, pensionimi, etj.)

Muaji janar për BNJ ishte jashtëzakonisht i ngarkuar me punë për përgatitjen e nisjes së vitit të ri të punës. Që nga fillimi i vitit, për shkak të mungesës së një baze të dhënash, ishim të detyruar

të fillonim përgatitjen e regjistrave për punëtorët aktiv, atyre që do të pensionohen gjatë vitit 2023, përvojën e punës, pushimet vjetore, mjekësore dhe statusore, si dhe shumë të dhëna tjera që do të përdoren si bazë për punë gjatë vitit.

BNJ kanë përgatitur regjistrat e punëtorëve aktiv, punëtorëve të cilët pensionohen gjatë vitit 2022, përvojës së punës, pushimeve vjetore, mjekësore dhe statusore, dhe shumë të dhëna tjera si bazë e punës vjetore.

Theksoj se gjatë kësaj periudhe kohore Resurset kanë qene në dispozicion të bashkëpunimit me Inspektoratin Punës duke iu përgjigjur çdo kërkesë lidhur me ankesat e parashtruara ndaj Infracos-it dhe duke ju ofruar dokumentacionet e nevojshme sipas kërkesave të tyre.

Punësimi - Gjatë tremujorit të parë 2023 INFRAKOS-i në bazë të konkursit publik, nga Bordi i përkohshëm është zgjedhur Kryeshefi Ekzekutiv me mandat të plotë.

Shpallja e konkurseve – janë shpallur tri konkurse, për zyrtar kryesor financiar i shpallur nga Bordi i përkohshëm i Drejtoreve, kurse nga KE-ja është shpallur një konkurs publik me katër pozita i cili është anuluar ndërkohë, i njëjti konkurs është shpallur në mënyrë interne, i cili është në procedurë.ee

Praktikant - në këtë periudhe në sektorin e komunikacionit kemi pranuar një praktikant pa pagesë.

Transferimi – Në këtë tremujor është bërë një transferim, nga pozita asistente e Kryeshefit është transferuar zyrtare e personeli.

Ndërprerje e marrëdhënies së punës - Gjatë kësaj periudhe kemi pasur një pensionim dhe një shkëputje të marrëdhënies së punës.

Disiplina në pune – BNJ ju kane shqiptuar vërejtje me shkrim punëtorëve për mos respektim të orarit të punës të evidentuar nga Kryeshefi dhe drejtori i Administratës. Pas shqiptimit të këtyre vërejtjeve disiplina në punë është përmirësuar dukshëm.

Pushim pa pagesë - Gjatë kësaj periudhe janë lejuar pushime pa pagesë për dy punëtorë:

Stafi me kontrata - Gjatë këtyre muajve janë pajisur me kontrata edhe 11- punëtor që janë transferuar në vazhdimësi, po ashtu edhe jemi duke vazhduar me pajisjen e stafit me kontrata të reja dhe do të ripërtërimë të gjithë kontratat e stafit të Infracos-it deri në fund të muajit prill, sipas planit të veprimit dhe rekomandimin e Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Pozitat me u.d. do të vazhdojnë ti kryejnë detyrat e tyre në pozitat si deri më tani.

Pagat dhe kompensimet tjera për punëtorët - Sa i përket dokumentacionit (evidenca e orëve të punës, puna e natës, puna jashtë orarit, puna në fundjavë, puna në festë, pushimi vjetor, pushimi mjekësor, pushimi statusor, etj.) të dërguar nga Burimet njerëzore për t'u proceduar të llogaritja e pagave secili dokument është i bazuar në ligj dhe në aktet tjera normative të cilat janë në fuqi.

Ofrimi i shërbimeve dhe informatave të nevojshme për punëtorët dhe palët e interesuara - Burimet njerëzore edhe gjatë këtij tremujori kanë kryer në vazhdimësi punë rreth pajisjes së punëtorëve, ish punëtorëve, anëtarëve të familjeve të tyre dhe palëve të treta me dokumentacion për nevojat e tyre personale.

Përcjellja e pushimeve vjetore, mjekësore dhe pushimeve tjera statusore – gjatë kësaj periudhe tre mujore, resurset njerëzore janë marrë edhe me menaxhimin e pushimeve vjetore të punëtorëve. Resurset njerëzore kanë bërë në mënyrë të rregullt zbatimin e kërkesave të

punonjësve për pushim vjetor. Nga punëtorët në vazhdimësi kërkohet të respektohen afatet ligjore për shfrytëzimin e pushimeve vjetore.

3.1.2 Shkrimorja dhe arkivi

Në protokollin e punës të shkrimores së INFRAKOS-it brenda kësaj periudhe kanë qarkulluar këto lëndë të natyrave të ndryshme:

| | |
|---|-----|
| Kërkesa hyrëse janë | 95 |
| Lëndët nga gjykata | 70 |
| Fatura hyrëse | 276 |
| Lëndët e punuara brenda dhe shpërndara jashtë | 102 |
| Lëndët punuara brenda dhe shpërndara brenda | 81 |
| Dërgesa me postë | 37 |
| Kontrata për dhënien e pronës me qira | 132 |
| Kontrata pune | 6 |
| Aplikacione për pozitë Zyrtar Kryesor i Financave | 5 |
| Aplikacione për pozitë Koordinator | 5 |
| Aplikacione për pozitë Certifikues | 7 |
| Aplikacione për pozitë Asistente | 5 |
| Aplikacione për pozitë Vozitës | 6 |

Nga protokollin Intern në këtë periudhë kohore janë dhënë në shërbim numrat rendor si në vijim:

| | |
|-------------|---|
| Nr. 2 | Bordit |
| Nr. 3 | Zyrës ligjore |
| Nr. 4 | Kontratat për punëtor |
| Nr. 5 | Vendimet për pushim vjetor |
| Nr. 6 | Vërtetimet |
| Nr. 7 | Faturat hyrëse |
| Nr. 8 dhe 9 | Regjistrimi i shkresave për rehabilitimin e linjës Faza 1 dhe 2 |

3.1.3 Shërbimi i logjistikës

Shërbimi i Logjistikës ka zhvilluar një aktivitet të konsideruar gjatë këtij tremujori në përpjekje për të përbushur objektivat e këtij shërbimi. Secila njësi dhe komplet shërbimi ka punuar në vazhdimësi për arritjen e objektivave të planifikuara, me gjithë vështirësitë që jemi ballafaquar në këtë periudhë për shkak të gjendjes dhe vjetërsisë së veturave. Përkundër kësaj, mirëmbajtja e veturave gjatë kësaj periudhe ka përbushur me sukses objektivat, ku është kryer servisimi i rregullt i të gjitha veturave, kompletimi me të gjitha pajisjet përcjellëse, pastrimi dhe furnizimi i

rregullt me naftë, përcjellja e fletudhëtimeve dhe kilometrave të kaluara për çdo veturë veç e veç dhe për të gjitha së bashku.

Në bashkëpunim me KK Fushë-Kosovë kemi marrë një aksion të përbashkët për pastrimin e hapësirave të gjëlbëra para drejtorisë së Infracos-it dhe sheshit të Lirisë përballë nyjës kryesore hekurudhore.

Pastrimi në përgjithësi ka arritur objektivat e veta ku me sukses ka arritur që të bëjë pastrimin e të gjitha hapësirave të objekteve dhe zyrave dhe ambientit të jashtëm.

Sfidë tjetër mbetet menaxhimi i lëvizjes së automjeteve nga sektorët të cilët jo gjithëherë i përdorin veturat në mënyrë racionale.

3.1.4 Shërbimi i sigurimit të objekteve

Gjatë periudhës tremujore e kemi pasur një dëmtim më q'rast është thyer një xham në ndërtesën e stacionit pritës, rasti është raportuar në polici dhe menjëherë është sanuar dëmi i shkaktuar. Përveç detyrave të rëndomta në sigurimin e objekteve nga punëtorët përkatës nuk ka pasur diçka tjetër për të evidentuar. Shërbimi është në fazën e kompletimit me staf adekuat profesional

4 Sektori për marrëdhënie me publikun dhe Media Shkollim Mbrojtje dhe Siguri në Punë

Sektori i Marrëdhënies me Publikun, Shkollim Mbrojtje në Punë është sektor i ri mbi bazën e strukturës organizative në kompaninë Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës Sh.A "INFRAKOS" i cili përmban në vete zyrtarin për informim dhe shërbimin për Shkollimi, Mbrojtje në Punë.

Ky sektor mbështetë kompaninë nga fusha të ndryshme profesionale të shërbimeve të lartpërmendur siç është: fusha e informimit dhe marrëdhënia me publikun, shkollimi permanent për stafin ekzekutiv, ngritja e kapaciteteve e stafit mbrojtja në punë etj.

Po ashtu, edhe sa i përket sigurisë në punë kemi një situatë relativisht të mirë, natyrisht jemi në përmirësim të vazhdueshëm të kushteve të punës se stafit dhe vendqëndrimeve të stafit.

Me poshtë janë paraqitur raportet e detajuara për secilin aktivitet.

- Marrëdhëniet me publikun dhe media
- Shkollimi siguria dhe mbrojtja në punë

4.1 Marrëdhëniet me publikun dhe media

gjatë kësaj periudhe ka përmbushur me sukses objektivat e saj, gjithëherë duke ndjekur rrugëtimin e përcaktuar me Planin e Veprimit për vitin 2023, duke ndërtuar strategji të pasqyrimin të medieve në përmirësimin e imazhit të kompanisë INFRAKOS.

Ky sektor mban kontakte të vazhdueshme dhe përcjell mediat elektronike në vazhdimësi, si dhe mirëmban dhe përditëson web faqen e kompanisë me të dhënat e nevojshme.

Po ashtu ky sektor kujdeset dhe bënë shqyrtimin e kërkesave fillestare nga palët e treta për qasje në asetet infrastrukturore siç janë: xhirime, videospote, vizita të muzeut etj.

Në fushën e marrëdhënieve me media dhe publikun të kësaj kompanie kemi arritur që me tej të jemi më të kërkuar në mbrojtjen e imazhit dhe pasqyrimin e kompanisë në përgjithësi.

Zyra për marrëdhënie me publikun dhe përkthime mban kontakte të vazhdueshme me media dhe hulumton materiale në adresa elektronike që ka të bëjë për INFRAKOS-in, si dhe merret me publicistikë në përditësimin me të dhëna në web faqen e kompanisë.

Po ashtu janë kryer detyrat e parapara si në vijim:

- Janë kryer të gjitha punët ditore të Zyrës për marrëdhënie me publikun.
- Aranzhohen rregullisht sipas kërkesave terminë për prononcime dhe intervista.
- Janë monitoruar të gjitha gazetat ditore, si dhe ato elektronik.
- Në mënyrë aktive sipas kërkesave nga palët e treta bëhet shqyrtimi i kërkesave fillestare për qasje në asetet infrastrukturore të hekurudhave.
- Janë hartuar, përmirësuar dhe të redaktuar të gjitha temat me rendësi të veçantë për Infracos-in
- Gjithashtu është punuar në përmbushjen e punëve dhe detyrave tjera të caktuara.

Gjatë kësaj periudhe janë veçuar materiale të publikuara në medie që kanë të bëjnë me kompaninë, materiale të cilat janë fotokopjuar, printuar dhe ruhen në arkivat e kësaj zyre së bashku me artikujt përkatës.

4.2 Shkollimi siguria dhe mbrojtja në punë

Gjatë kësaj periudhe është përcjell plani i veprimit për periudhën TM1 si dhe janë përmbushur të gjitha detyrat konformë akteve të brendshme të kompanisë.

Më poshtë i keni disa aktivitete të përgjithshme nga ky sektor:

- Menaxhimi i rregullt dhe përmbushja e objektivave nga Plani i Biznesit - 2023
- Shkollimi i rregullt për stafin ekzekutiv
- Organizimi dhe mbajtja e provimeve profesionale dhe periodike
- Trajnimet e personelit
- Mbikëqyrja e gjendjes shëndetësore në bazë të rregullores për kushte shëndetësore
- Mbrojtja e shëndetit, ambientit dhe siguria në punë
- Mbrojtja nga zjarri dhe fatkeqësitë natyrore

4.2.1 Shkollimi i Rregullt për stafin Ekzekutiv të Infrakos-it

Proceset e punës në Kompani dhe specifikat e saj ndonjëherë e mundësojnë shfrytëzimin optimal të stafit ekzistues por që shtrën nevojën që herë pas here të rishqyrtohen, analizohen dhe definohen me qëllim të shfrytëzimit maksimal të ngritjes së kapaciteteve ekzistuese.

Shërbimi për Shkollim/Trajnim, Mbrojtje dhe Siguri ka përgatitur planin për përgatitjen-Shkollimin e stafit ekzekutiv të Infrakos-it në bazë të planit dhe udhëzimit për shkollim.

Shkollimi permanent realizohet duke u bazuar në rregulloret dhe aktet e brendshme të Kompanisë.

Në bazë të planit të shkollimit është mbajtur si në vijim:

Hani i Elezit, Ferizaj, Pejë dhe Qendër në Fushë Kosovë, trajnimet janë mbajtur për drejtues të trenit, krye ndërrues, ndërrues dhe rojtar vend kalimi.

Ne jemi dakorduar që të mbahen shkollimet permanente nga departamentet përkatëse pasi që sektori në fjalë i mungojnë zyrtaret e shkollimit të këtyre fushave.

Shkollimi për stafin ekzekutiv përgjatë kësaj periudhe është mbajtur me një rezultat të kënaqshëm.

4.2.2 Trajnimet për e Stafit te Kompanisë Infrakos Sh.a

Në përdhën Janar - Mars të vitit 2023 edhe përkundër faktit të kërkesave që kemi pasur në si sektor nuk e kemi iniciuar asnjë kërkesë për ngritje të kapaciteteve (trajnime) duke pas parasysh gjendjen e vështirë financiare të kompanisë.

4.2.3 Organizimi dhe mbikëqyrja e kontrollimeve të rregullta mjekësore të punëtorëve

Në mënyrë që komunikacioni hekurudhor të jetë sa më i sigurt, Departamenti ka hartuar planin e veprimit në mënyrë që gjatë gjithë kohës të përcjell gjendjen psiko – fizike të punëtorëve.

Këtë e bëjmë përmes kontrollimeve të rregullta-sistematik mjekësor të tyre, në bazë të kushteve dhe kritereve të parapara në Rregulloren mbi aftësinë psiko-fizike të punëtorëve të cilët drejtpërdrejtë marrin pjesë në sektorin e komunikacionit, Sektorin e Sinjalizimit, shërbimin i Energjetikes, Terminalit dhe Shërbimi CTC

4.2.4 Mbrojtja e shëndetit, ambientit dhe siguria në punë

Ky sektor rregullisht e parashihet buxhetin për furnizim të rrobave mbrojtëse të sezonit dimëror dhe veror, mirëpo duke pas parasysh gjendjen e vështirë financiare, ne si sektor kemi bërë përpjekje që ky projekt të mbetet që të arsyetohet në mënyrë që të vazhdoi realizimi i këtij projekti me mjetet nga buxheti i Republikës së Kosovës.

Vlen të përmendet se gjatë kësaj periudhe sektori i MPM.SHMSP është angazhuar për të marrë të gjitha veprimet e nevojshme për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi.

4.2.5 Mbikëqyrja dhe inspektimi

Lidhur me mbikëqyrjen dhe inspektimin e vendeve të punës dhe ndërmarrjen e masave lidhur me sigurinë në punë dhe mbrojtjen e shëndetit të punëtorëve Sektori për shkollim, siguri dhe mbrojtje në punë ka bërë identifikimin e nevojave për përmirësimin e këtyre kushteve në shumë stacione hekurudhore dhe njësi punuese duke përdorur metoda me adekuate të përfituara nga projekti i OSH-së.

Vlen të përmendet se sektori përkatës gjatë kësaj periudhe është duke u marrë me identifikimin e pajisjeve për ndihmën e parë që janë të vendosura në stacione, deri me tani linja e Prishtinë - Fushë Kosovë – Pejë ka përfunduar dhe mbetet që të vazhdohet linja e Mitrovicës dhe Hanit të Elezit.

4.2.6 Mbrojtja nga zjarri dhe fatkeqësitë natyrore

Sa i përket rrezikut nga zjarri ky sektor ka iniciua procedurë dhe është bërë servisimi dhe mbushja e aparateve të zjarrit gjë që e rrit nivelin e sigurisë të mbrojtjes kundër zjarrit.

Po ashtu sektori përkatës i rekomandon kompanisë që ta bëjë identifikimin e këtyre aparateve kundër zjarrit në bashkëpunim me agjencinë e emergjencave në testimin e tyre pasi që këto pajisje janë të vjetra, dhe nëse ka nevojë të furnizohemi me aparate të reja.

5 Sektori i patundshmërisë

Sektori i patundshmërisë është i angazhuar në punën dhe menaxhimin e pronave. Në këtë tremujor sektori i pronave ka arritur ti përpiloj 140 kontrata për lokalet afariste nga to janë nënshkruar 118. Megjithatë, në procedurë të nënshkrimit nga ana e palëve janë 10 kontrata të tjera për lokale dhe banesa. Ndërkaq, kompania ka arritur të nënshkruajë edhe 2 kontrata vazhduese të reja për lokale afariste, ndërsa janë në procedurë të vazhdimit edhe 2 kontrata për banesa dhe 8 kontrata për lokalet afariste.

Ndërmarrja ka përpiluar pyetësorët për klientët, ku nga këta pyetësor kemi arritur ti pasqyrojmë rezultatet e kënaqshmërisë së klientëve tonë.

Po ashtu gjatë kësaj periudhe kohore është realizuar shpallja publike për dhënien e pronave me qira, nga kjo shpallje janë shtuar edhe 20 kontrata të reja.

Sektori i Pronës, ka punuar në vazhdimësi për menaxhimin e suksesshëm të pronës. Në tabelën vijuese ju prezantoj:

Tabela 7. Të dhënat kryesore për tremujorin e parë në sektorin e pronës

| Përmbajtja | Obliq | Mitrovicë | Bardh i Maadh | Drenas | Klinë | Pejë | Xërë | Prizren | Krush-Rahovec | Fushë Kosovë | Miradi | Hani Elezit | Kaçanik | Ferizaj | Lipjan | Prishtinë, Bardhosh | Podujevë | Vranidoll | Lozhan | Prelluzh | Vushtrri | Leshak | Totali |
|---|-------|-----------|---------------|--------|-------|------|------|---------|---------------|--------------|--------|-------------|---------|---------|--------|---------------------|----------|-----------|--------|----------|----------|--------|--------|
| Kontratat e lokaleve vazhduese | 2 | 5 | 5 | 6 | 2 | 29 | 6 | 5 | 27 | 1 | 5 | 11 | 6 | 7 | 1 | | | | | | | | 118 |
| Kontratat e lokaleve vazhduese në procedurë | 1 | 1 | | | | 1 | 1 | | 4 | | | | | | | | | | | | | | 8 |
| Kontrata e banesave Vazhduese | 1 | | | 1 | | | | | 4 | 1 | | | | | | | | | | | | 3 | 10 |
| Kontratat e banesave Vazhduese në procedurë | | | | 1 | | | | | 1 | | | | | | | | | | | | | | 2 |
| Kontrata e reja lokaleve | | | | | | 1 | | | | | | | | 1 | | | | | | | | | 2 |
| Shkresat dhe kërkesa për komunat | 1 | 1 | | 1 | 1 | 1 | | 3 | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | | | | | | 15 |
| Kërkesat | 3 | | 1 | | 1 | 6 | 1 | 5 | 3 | 1 | | 1 | | 1 | | 1 | 2 | | | | | | 25 |
| Kërkesa me përgjigje nga Prona | | | 1 | | 1 | 1 | 1 | 3 | 1 | 1 | | | | | | 1 | 2 | | | | | | 12 |
| Kërkesa në procedurë të prona | 3 | | | | | | | | | | | | | 1 | | | | | | | | | 4 |
| Kërkesa të dërguara te komisioni | | | 1 | | 1 | 5 | | 2 | 2 | | | | | | | 1 | 2 | | | | | | 14 |
| Kërkesat në procedurë të komisioni në procedurë | | | | | 1 | 3 | | 2 | | | | | | | | 1 | 1 | | | | | | 8 |
| Pëlqime nga komisioni profesional dhe prona | | | | | 1 | 2 | | | | | | | | | | | | 1 | | | | | 4 |
| Refuzime nga komisioni profesional dhe prona | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Propozime për procedurë gjyqësore në ZL | 3 | 5 | 2 | | 5 | 1 | | | | | | | | | | | 1 | | | | | | 17 |
| Njoftime për mos dhënien e pronës me nën-qira | 7 | 39 | 6 | 12 | 7 | 53 | 7 | 23 | 39 | 5 | 20 | 23 | 9 | 17 | 7 | 7 | | | | | | | 281 |
| Pyetësorët rreth kënaqshmërisë së klientëve | 7 | 39 | 6 | 12 | 7 | 53 | 7 | 23 | 39 | 5 | 20 | 23 | 9 | 17 | 7 | 7 | | | | | | | 281 |

6 Sektori i prokurimit

Departamenti i Prokurimit gjatë tremujorit të parë të këtij viti i ka kushtuar kujdes të veçantë zbatimit të procedurave të furnizimit të kompanisë, duke garantuar kështu stabilitetin financiar, por edhe duke i plotësuar nevojat e kompanisë për punë të rregullt. Në bazë të planifikimit të prokurimit i cili është marrë nga projektet e aprovuara në buxhet, Departamenti i Prokurimit ka iniciuar procedurat sipas kohës së planifikuar për tenderim të projekteve dhe zbatimin e tyre. Prandaj, gjatë kësaj periudhe kohore departamenti i prokurimit është marrë me dy lloje të projekteve:

- Projektet kapitale të realizuara nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës
- Projektet e furnizimit të realizuara nga Buxheti INFRAKOS-it.

6.1 Projektet kapitale nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës

Sipas të dhënave të cilat i menaxhon Departamenti i Prokurimit, nga mjetet e Buxhetit të Kosovës akoma nuk janë zhvilluar aktivitetet e përgatitjes së dokumenteve përkatëse lidhur me publikimin e projekteve kapitale të cilat priten të realizohen sipas planifikimit paraprak të përcaktuar me Planin e Biznesit 2023. Arsyeja qëndron në mos nënshkrimin e marrëveshjes së mirëkuptimit, monitorimit dhe kontrollit ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë dhe INFRAKOS-it..

6.2 Projektet e furnizimit nga Buxheti i INFRAKOS-it

Varësisht nga kërkesat e njërive kërkuese dhe duke u bazuar në procedurat e prokurimit, gjatë kësaj periudhe kohore është realizuar me sukses furnizimi i të gjitha pjesëve rezervë dhe materialit tjetër të kërkuar nga të gjithë sektorët e INFRAKOS-it.

Departamenti i Prokurimit pas pranimit të kërkesave të aprovuara, ka zhvilluar procedurat e prokurimit dhe ka nënshkruar kontratat për furnizim për 5 projekte të ndryshme. Vlera e parashikuar e këtyre projekteve ka qenë 3,445.00 €, ndërsa vlera e kontraktuar është 3,354.60 €. Ndërsa në procedurë janë 2 kontrata me vlerë të parashikuar 3,480.00 € janë ende në procedurë.

7 Kontrollori i brendshëm

Ky raport përfshinë aktivitetet tremujore të kontrollimit e të gjithë sektorëve ekzekutiv të kategorizuar në tri grupe:

- Kontrolli në stacione;
- Kontrolli në linjat hekurudhore, gjendja tyre;
- Kontrolli i stafit ekzekutiv.

Aktivitetet në TM1 2023 janë përmbledhur si në vijim:

- Përcjellja e trenave është bërë sipas planit të kontrollit dhe për vërejtjet e konstatuara janë hartuar raportet e nevojshme dhe janë dërguar në baza javore me kohë;
- Kontrollime, analiza në stacione, duke raportuar në formë ditore, javore dhe mujore për gjendjen në stacione dhe të shërbimeve në hekurudhat e Kosovës;
- Shkollimi i rregullt në Sektorin për Rregullimin e Komunikacionit është mbajtur nga shefat e stacioneve sipas plan programit për vitin 2023;
- Kontrollimi i teknik i ndërrueseve në tërë linjën hekurudhore është kryer në bashkëpunim me Departamentin e MLH-ës, Sektorin e Komunikacionit dhe Shërbimin e SS-it;
- Kontrollimi i vijës hekurudhore Fushë Kosovë – Pejë;
- Kontrollimi i pajisjeve sinjalo-siguruese, shenjave treguese dhe kanaleve anësore për kullimin e ujit nga të reshurat atmosferike;
- Kontroll në stacionet Miradi, Lipjan, Bablak, Gurëz, Kaçanik, H. Elezit, Bardh, Drenas, Klinë, Pejë, Kastriot, Vushtrri, Mitrovicë;
- Kontrollimi i linjës hekurudhore Fushë Kosovë-Hani Elezit. Punimet në linjën hekurudhore Fushë Kosovë-Hani i Elezit janë prezantuar përmes fotografive në vijim.



Sa i përket organizimit të lëvizjeve të trenave të mallrave, operatori i transportit Railtrans vazhdon revokimin e trenave dhe në këtë periudhë ka operuar vetëm operatori Trainkos.

Në relacionin F. Kosovë-Drenas vazhdon faza testuese e katër vendkalime të mbrojtura me barriera automatike deri tek pranimi i tyre dhe licencimi nga organet kompetente, ndërsa vendkalimi në kilometrin 19+453 gjendet në prishje për shkak të dëmtimit nga pala e tretë.

Në linjën Fushë Kosovë-Hani i Elezit kanë vazhduar punimet për rehabilitimin e Linjës 10, ku kryesisht është duke u punuar në stacionin hekurudhor Fushë Kosovë në rehabilitimin e binarëve

1,2,3,4, si dhe ndërrueseve, po ashtu në vendosjen e ndërrueseve është punuar edhe në stacionet Miradi Lipjan, Gurëz, Kaçanik, dhe Han të Elezit. Linja hekurudhore Fushë-Kosovë – Hani i Elezit që nga shtatori i vitit 2022 ka qenë e mbyllur si pasojë e shembjes së tunelit 6 dhe 7, ku gjatë kësaj periudhe tremujore është punuar në sanimin shembjes dhe kthimin në funksion të tuneleve, tuneli 6 është në përfundim të zgjerimit ndërsa në tunelin 7 është bërë injektimi i zbrazëtirave të krijuara nga shembja.



Gjatë TM1 2023 ka pasur dy raste të jashtëzakonshme, fatmirësisht rastet nuk kanë përfunduar me fatalitet në njerëz. Të dy rastet kanë ndodhur për shkak të pakujdesisë dhe mos respektimit të shenjave nga ana e drejtuesve të automjeteve rrugore, për çka nuk mbanë përgjegjësi INFRAKOS-i.

Në këtë tremujor është përcjellë dhe është bërë kontrolli teknikë i ndërrueseve përgjatë linjave hekurudhore nga Sektori i MLH-ës në bashkëpunim me Sektorin e Komunikacionit dhe Shërbimin e SS-it.

Vlen të ceket se përkundër problemeve të caktuara, departamentet ekzekutive i kanë kryer me sukses detyrat e parapara me planet e veprimit për tremujorin e parë të vitit 2023.

8 Performance finanziaria e INFRAKOS-it



8 Performanca financiare e INFRAKOS-it

Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës Sh.A, përkundër një numri të konsideruar të vështirësive ka pasur një angazhim maksimal drejt realizimit të detyrave të parapara në drejtim të ruajtjes së funksionimit të kompanisë duke pasur parasysh gjendjen jo të mirë financiare e cila na ka përcjellë edhe në këtë periudhë kohore.

Për fat të keq muajt e tremujorit të parë nuk është bërë subvencionimi i pritur kështu që kjo e ka vështirësuar tej mase situatën edhe ashtu të vështirë financiare. Për sqarim më të mirë, në tabelën vijuese është bërë prezantimi i të hyrave dhe shpenzimeve për këta tre muaj, duke e bërë krahasimin me të njëjtën periudhë kohore të vitit paraprak.

Tabela 8. Të hyrat dhe shpenzimet në TM1 2023

| Krahasimi i të hyrave dhe shpenzimeve për muajin shkurt 2023 dhe 2022 | | Realizimi 2022 | Realizimi 2023 | Buxheti 2023 | Diferenca | Diferenca |
|---|---------------------------------------|-------------------|-------------------|---------------------|------------------|--------------------|
| | | A | B | C | B - A | B - C |
| TË HYRAT | Të hyrat nga TM | 205.86 | - | 19,500.00 | -205.86) | -19,500.00 |
| | Të hyrat nga TU | 42,607.15 | 41,880.78 | 51,249.99 | -726.37 | -9,369.21 |
| | Të hyrat nga qiraja | 194,931.78 | 217,919.39 | 186,999.99 | 22,987.61 | 30,919.40 |
| | Të hyrat tjera | 29,225.63 | 34,452.98 | 24,876.00 | 5,227.35 | 9,577.64 |
| | Të hyrat shtyera nga granti BK | 220,094.94 | 230,929.20 | 207,500.01 | 10,834.26 | 23,429.19 |
| | Subvencionimi i diferencës së rrjetit | - | - | 90,000.00 | - | -90,000.00 |
| | Sub. për dif.e tarifave nga ER | - | - | 616,984.26 | - | -616,984.26 |
| | Të hyrat totale | 487,065.36 | 525,182.35 | 1,197,109.59 | 38,116.99 | -671,927.24 |
| SHPENZIMET | Pajisjet | 80.51 | 80.08 | 5,300.00 | -0.43 | -5,219.92 |
| | Harxh. e lokal. ndërtesave | 12,834.82 | 6,377.87 | 7,500.00 | -6,456.95 | -1,122.13 |
| | Energjia elektrike | 28,009.35 | 33,293.57 | 61,000.00 | 5,284.22 | -27,706.43 |
| | Nafta | 4,958.08 | 4,931.08 | 13,750.00 | -27.00 | -8,818.92 |
| | Vajrat, lyerësit, etj. | 16.50 | 252.80 | 0.00 | 236.30 | 252.80 |
| | Materiali harxhues operativ | 2,857.54 | 84.29 | 4,260.00 | -2,773.25 | -4,175.71 |
| | Riparimet | 2,356.11 | 2,185.42 | 9,095.00 | -170.69 | -6,909.58 |
| | Shërbimet operative | 30,511.37 | - | 0.00 | -30,511.37 | - |
| | Udhëtimet zyrtare | 249.00 | 410.13 | 384.00 | 161.13 | 26.13 |
| | Marketingu dhe publikimet | 294.00 | 1,125.43 | 994.00 | 831.43 | 131.43 |
| | Mat. i zyrës dhe konsumues | 505.76 | 4,077.78 | 7,450.00 | 3,572.02 | -3,372.22 |

| | | | | | |
|-----------------------------------|------------|------------|--------------|------------|-------------|
| Telefoni / mail / interneti | 1,867.63 | 2,375.04 | 4,350.00 | 507.41 | -1,974.96 |
| Shpenz. e rrezikshmërisë | 1,683.40 | 23,121.03 | 70,875.00 | 21,437.63 | -47,753.97 |
| Reprezetntac./ konsumueset | 2,118.50 | 1,364.89 | 2,270.00 | -753.61 | -905.11 |
| Sigurimi | 1,937.24 | 23,130.07 | 8,600.00 | 21,192.83 | 14,530.07 |
| Stafi i jashtëm | 14.36 | 940.00 | 1,000.00 | 925.64 | 60.00 |
| Stafi dhe punëtorët | 446,646.54 | 435,311.29 | 577,475.00 | -11,335.25 | -142,163.71 |
| Shpenzimet tjera operative | 1,555.00 | 1,000.00 | 262,400.00 | -555.00 | -261,400.00 |
| Gjithsejtë shpenzimet | 538,495.71 | 540,060.77 | 1,036,703.00 | 1,565.06 | -496,642.23 |
| Diferenca (Të hyrat – Shpenzimet) | -51,430.35 | -14,878.42 | 160,406.59 | 36,551.93 | -175,285.01 |

| | |
|--|---------------------|
| Të hyrat TM1 2023 | 525,182.35 |
| Të hyrat TM1 2022 | 487,065.36 |
| Të hyrat e planifikuara me buxhet TM1 2023 | 1,197,109.59 |
| Shpenzimet operative të realizuara TM1 2023 | 540,060.77 |
| Shpenzimet operative të realizuara TM1 2022 | 538,495.71 |
| Shpenzimet operative të Planifikuara TM1 2023 | 1,036,703.00 |

8.1 Të hyrat

Të hyrat e INFRAKOS-it për TM1 2023 janë prezantuar në tabelën e mësipërme dhe si zakonisht këto të hyra përbëhen nga të hyrat e pagesave të qasjes në binarë (shfrytëzimi i rrjetit), të hyrat nga patundshmëria, të hyrat tjera dhe të hyrat nga subvencionimi. Në vijim është bërë përshkrimi i të hyrave të realizuara për secilin segment duke e bërë krahasimin e tyre me buxhetin e planifikuar dhe vitin paraprak.

8.1.1 Të hyrat nga shfrytëzimi i rrjetit

Për periudhën TM1 2023 janë realizuar 525,182.35€ në total apo 44% nga shuma e buxhetit të paraparë prej 1,197,109.59€ e krahasuar me periudhën TM1 2022 kemi realizim prej 38,116.99€ me shumë apo e shprehur në përqindje 8%.

8.1.2 Transporti i mallrave

Për periudhën TM1 realizimi është 0.00€ është nga shfrytëzimi të rrjetit hekurudhor për transportin e mallrave që krahasuar me buxhet është realizuar vetëm 0% të buxhetit ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të 2022 kemi realizim prej 0.0%;

8.1.3 Transporti i udhëtarëve & shërbimet

Të hyrat e realizuara nga shfrytëzimi i rrjetit hekurudhor për transport të udhëtarëve dhe shërbimeve është 41,880.78€ apo 82% është realizuar krahasuar me buxhet ndërsa krahasuar

me të njëjtën periudhë me vitin e kaluar - 2022 kemi 726.37€ realizim më pak ndërsa e shprehur ne përqindje kemi të hyra prej 2% më pak.

8.1.4 Të hyrat nga qiraja

Gjatë kësaj periudhë janë realizuar 217,919.39€ e që e shprehur në përqindje është 117% nga planifikimi për këtë periudhë ku buxheti i planifikuar ka qenë 186,999.99€.Pra kemi tejkalim realizim të parashikimeve buxhetore për 17% ndërsa krahasuar me periudhën e njëjtë me vitin e kaluar 2022 vlera e të cilave ka qenë 194,931.78€ apo shprehur në përqindje kemi 12% më shumë të hyra, ky tejkalim i realizimit të parashikimeve buxhetore është si rezultat i angazhimeve të mëdha për nënshkrimin e kontratave të reja dhe ripërtëritja e kontratave aktuale.

8.1.5 Të hyrat tjera

Për këtë periudhë janë realizuar 34,452.98€, ndërsa të planifikuara ka qenë 24,876.00€. e shprehur në përqindje është 138% Pra kemi tejkalim realizim të parashikimeve buxhetore për 38% më shumë të nga parashikimet, krahasuar me vitin e kaluar 2022 vlera e të cilave ishte 29,225.63€, pra kemi tejkalim realizim të vitit 2022 për 18%

8.1.6 Subvencionimi për diferencën e tarifave

Për tremujorin e parë subvencionimi i planifikuar për diferencës në mes të pagesave nga qasja në rrjet dhe kostos direkte të mirëmbajtjes prej 616,984.26 €, nuk është realizuar, andaj pritët që ky subvencion të realizohet në muajt vijues.

8.2 Shpenzimet

8.2.1 Shpenzimet e planifikuara dhe realizuara

Sa i përket shpenzimeve mund të konstatojmë se shpenzimet e realizuara në këtë periudhë janë 540,060.77 € që në krahasim me shpenzimet e planifikuara 1,036,703.00 €, janë 496,642.23€ apo shprehur në përqindje 52% janë më të vogla. Nëse këto shpenzime i krahasojmë me vitin 2022, vlera e të cilave ishte 538,495.71 €, atëherë del se në krahasim me vitin paraprak ne kemi shpenzuar 1,565.06 € më shumë se në të njëjtën periudhë të vitit 2022.

Nga tabela e mësipërme shihet se shumica e shpenzimeve kanë qenë më të vogla sesa shpenzimet e planifikuara. Të vetmet tejkalime të shpenzimeve janë bërë te sigurimi.

8.2.2 Krahasimi i të hyrave dhe shpenzimeve

Bazuar në tabelën e mësipërme e të hyrave dhe shpenzimeve shihet se diferenca në mes të hyrave të realizuara 525,182.35€ dhe shpenzimeve të realizuara 540,060.77€ ku janë për 14,878.42 € më të mëdha sesa të hyrat e realizuara.

8.2.3 Transaksionet financiare

Për periudhën (janar – mars) 2023, Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës ShA – INFRAKOS nuk ka pasur ndonjë transaksion të madh të mjeteve i cili vlen të përmendët. Pra, gjatë këtyre tre muajve janë bërë vetëm pagesat për shpenzimet operative, si dhe pagesat për furnizime të cilat nuk kanë pasur ndonjë vlerë të madhe e cila do të vliente të përmendët. Çka është më me rëndësi, të gjitha transaksionet janë bërë sipas ligjeve dhe rregulloreve tjera në fuqi për menaxhimin e financave.

9 Procedurat gjyqësore



9 Procedurat gjyqësore të INFRAKOS-it

Sektori ligjor i INFRAKOS-it gjatë periudhës TM1 - 2023 ka vazhduar me përfaqësimin e kompanisë në Gjykata, gjatë kësaj periudhe stafi i sektorit ligjor si në përfaqësimet, ashtu edhe në procedurë përmbartimore ka zhvilluar një punë të pandërprerë dhe profesionale me qëllim të mbrojtjes së interesit të ndërmarrjes.

Aktivitetet dhe rezultatet

Në fund të TM1 pas shqyrtimit analitik të lëndëve, kemi konstatuar së në Zyrën Ligjore kemi gjendjen si në vijim:

- Në fund të periudhës së TM1, kemi 339 lëndë aktive në procedura ligjore.
- Gjatë TM1 janë iniciuar 3 padi të reja;
- Gjatë TM1 ka arritur 1 padi kundër Infrakos;
- Gjatë TM1 janë parashtruar 3 njoftime penale;
- Gjatë TM1 kanë përfunduar 5 lëndë;
- Në procedurë përmbartimore, në fund të periudhës së TM1, kemi 208, lëndë aktive (Nga të cilat në 190 raste jemi kreditor, kurse në 18 raste jemi debitor),
- Gjatë TM1 janë iniciuar 14 lëndë në procedurë përmbartimore në vlerë 69,466.30€
- Gjatë TM1 kanë arritur 3 lëndë kundër Infrakos në procedurë përmbartimore në vlerë 2650.75€.
- Gjatë TM1 kanë përfunduar 11 raste përmbartimore;
- Nga gjykata kanë arritur 21 vendime Gjyqësorë, Nga të cilat 9 janë në favor të Infrakos dhe 12 në disfavor. (Rastet në disfavor kryesisht kanë të bëjnë me mos njohje të kompensimit për fitim të humbur nga shfrytëzimi i pronës në Prizren, aksidente dhe borxhe).
- Janë mbajtur 46 seanca gjyqësore dhe është punuar në përgatitjen e lëndëve dhe parashtrësive të ndryshme ligjore.
- Gjatë kësaj periudhe po ashtu janë mbajtur kontaktet me përmbartuesit privat të angazhuar më lëndët e Infrakos dhe në vazhdimësi kërkohet angazhim me i madh në drejtim të ekzekutimit të rasteve. Ngecjet janë kryesisht për shkak të mungesës së të dhënave pasi që kemi të bëjmë me lëndë të vjetra.
- Stafi i sektorit ligjor ka një angazhim të vazhdueshme në azhurnimin e bazës së të dhënave për lëndët në gjykata dhe procedurë përmbartimore në mënyrë që menaxhmenti i kompanisë të mund të ketë një pasqyrë të qartë të vlerësimit të rrezikut dhe trendëve nga procedurat ligjore.

9.1 Procedurat gjyqësore të INFRAKOS-it për tremujorin vijues

Në tremujorin vijues INFRAKOS-in e presin kontestet gjyqësore të natyrës së njëjtë të cilat janë të ndërlidhura me pagesat e borxheve ndaj kompanisë, uzurpimin e pronës, çështjet banesore, dëmet e infrastrukturës, vërtetimin e pronësisë etj. Mund të ketë edhe ndonjë kontest të ri të natyrës tjetër, por pa marrë parasysh llojin dhe numrin e kontesteve, Zyra Ligjore e INFRAKOS-it angazhohet që me përkushtim t'i mbrojë dhe përfaqësoj interesat e kompanisë

Zyra ligjore e Infrakos paraqet si raste me rrezikshmëri të lartë dy konteste që ndërlidhen me marrëdhënien e punës e që në total mund të arrijnë vlerën prej rreth 130,000€ (rastet me numër rendor 305 dhe 329 si dhe disa raste për kompensim nga shpronësimet viteve 1960 në Komunën e Prizrenit)

9.2 Përfundimet/sugjerimet dhe rekomandimet

Gjatë periudhës TM1 2023, stafi i sektorit ligjor ka qenë i angazhuar edhe në punë dhe detyra tjera në Kompani. Aktualisht stafi i sektorit ligjor është duke e përballuar mirë fluksin e punëve të lëndëve në gjykata dhe përmbarim. Me qëllim të përmirësimit të vazhdueshëm të proceseve brenda kompanisë, po e ritheksojmë se sektori ligjor sugjeron që:

- Të bëhet mirëmbajtja adekuatë e dosjeve të klientëve në kompani me fatura origjinale dhe dokumentet tjera, menaxhimi i duhur dhe efikas i kontratave të qirave dhe afateve të pagesave për shkak të rrezikut nga parashkrimi dhe mos krijimi i borxheve është e domosdoshme për efikasitet në procedura ligjore, veçanërisht ato përmbarimore.
- Të ndërmerren veprime konkrete dhe të vazhdueshme që të evidentohen dhe pengohen në shfrytëzuesit e paautorizuar të pronës, në rast se ka të tilla, në mënyrë që të ndërpritet çfarëdo afati i parashkrimeve fituese dhe të manifestohet vullneti i Infracos për menaxhimin e pronës.
- Duhet të trajtohet çështja e ndërtimeve në pronën e Infracos në Mitrovicë se si t'i qasemi kësaj problematike.
- Të trajtohen rastet e borxhlinjve, veçanërisht atyre me shuma të larta dhe të sigurohemi që të mos tejkalojnë afatin 3 vjeçar pa iniciuar procedura ligjore.
- Të përfillen plotësisht procedurat ligjore dhe aktet e brendshme të kompanisë në mënyrë që të shmangen kontestet ligjore që krijojnë pozicion të vështirë për kompaninë.

Krahas punëve të rregullta, sektori ligjor në vazhdimësi koordinon veprimet me departamentin e pronës dhe financave për procedimin e lëndëve në procedura përmbarimore, gjykata si dhe kompletimin e dosjeve me dokumentacionin e nevojshëm.

10 Ngritja e performancës



10 Sugjerimet për ngritjen e performancës

INFRAKOS-i si Menaxher i Infrastrukturës Hekurudhore prioritetin kryesor në tremujorin e parë të këtij viti e ka pasur mirëmbajtjen e infrastrukturës ashtu që organizimi i trafikut hekurudhor të bëhet pa pengesa dhe në nivelin më të lartë të sigurisë. Sfidat me të cilat jemi përballur në këtë tremujor kanë qenë shumë të mëdha dhe akoma mbesin të tilla, përderisa të mos ndërmerren hapat e duhur nga institucionet përgjegjëse qeveritare. INFRAKOS ka qenë dhe është angazhuar maksimalisht për kryerjen e detyrave, andaj duke ditur rëndësinë e madhe që ka hekurudha, INFRAKOS pret që edhe institucionet përkatëse të bëjnë detyrat e veta.

Si zakonisht, edhe në tremujorin e parë të këtij viti problemi numër një ndërlihet me mos pagesën e subvencionimit të kërkuar nga Qeveria, me çka po cenohet funksionimi i kompanisë. Për këtë arsye kërkohet me urgjencën më të madhe angazhimi i menjëhershëm i të gjitha institucioneve përgjegjëse për zgjidhjen e problemit financiar të INFRAKOS-it. Këtu bëhet fjalë për Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës si dhe Ministrinë e Ekonomisë të cilat sipas Ligjit mbi Hekurudhat Nr. 04/L-063 janë përgjegjëse për nënshkrimin e Marrëveshjes Financiare Pesëvjeçare me INFRAKOS-in. Infracos kërkon nga këto dy ministri që të rishikojnë Draft Marrëveshjen Financiare Pesëvjeçare (2023 – 2027) dhe të bëjnë nënshkrimin e saj, ashtu që të mos cenohet funksionimi i transportit hekurudhor, ndërsa në ndërkohë të shqyrtojnë dhe miratojnë kërkesën tonë për subvencionimin e INFRAKOS-it për vitin 2023.

Duke ditur që gjendja në tremujorin e parë sa i përket të hyrave nuk ka qenë e kënaqshme dhe atë kryesisht pa fajin e INFRAKOS-it, sepse të hyrat kryesore të kësaj kompanie varen prej operatorëve të transportit (TRAINKOS dhe RAILTRANS), atëherë sugjerimet tona për tremujorin vijues janë si vijon:

- Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë të realizojnë obligimet e tyre ligjore për subvencionimin e plotë të INFRAKOS-it për vitin 2023 duke i mbuluar kështu në tërësi kostot direkte të mirëmbajtjes së infrastrukturës;
- Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë të nënshkruajnë marrëveshjen financiare pesëvjeçare (2023 – 2027) e cila është hartuar në bazë të Planit shtatëvjeçar të biznesi;
- TRAINKOS si operator i transportit hekurudhor të udhëtarëve dhe mallrave të angazhohet më shumë në rritjen e vëllimit të transportit duke ofruar kështu shërbime cilësore dhe efikase;
- Institucionet komunale dhe ato gjyqësore të angazhohen shumë më tepër në mbrojtjen e pronës së INFRAKOS-it e cila uzurpohet dhe keqpërdoret nga personat e ndryshëm fizik dhe juridik;
- Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës njëherë e përgjithmonë të hartoj, miratoj dhe zbatoj strategji të mirëfillta zhvillimore për sektorin hekurudhor;
- INFRAKOS-i të vazhdojë me urgjencë ndërmarrjen e të gjitha masave për mbledhjen e borxheve të cilat të tjerët i kanë ndaj kësaj kompanie;
- INFRAKOS-i të vazhdojë me reduktimin e shpenzimeve me përjashtim të atyre të cilat janë të lidhura me sigurinë e komunikacionit hekurudhor;
- INFRAKOS-i të përfundoj hartimin e strategjisë zhvillimore të pronës, strategji kjo e cila është rëndësisë së veçantë për menaxhimin e mirëfilltë të pronës dhe krijimin e të hyrave;
- INFRAKOS-i të ketë angazhim maksimal në realizimin e projekteve zhvillimore të infrastrukturës hekurudhore.